



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira - Department of Freelance Professions  
Departamenti për Profesione të Lira - Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.30/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.136/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, , pala ankuese nga dhe Përmbaruesi Privat, me datë 22.12.2022, mori këtë:

## V E N D I M

Përmbaruesi Privat i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit, në veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.136/2022, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,200.00 euro (njëmijë e dyqind euro), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, nën kërcënimin e përmbarimit.

## Arsyetim

Pala ankuese me datë 14.11.2022, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat, duke theksuar se përmbaruesi privat me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore, P.nr.136/2022, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke i tejkaluar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj. Më tej pala ankuese ka deklaruar se për faturën e inicuar në përmbarim, asnjëherë nuk ka qenë e njoftuar dhe se asnjëherë nuk e ka angazhuar kreditorin si avokat në këtë rast gjyqësor që ka pasur të bëjë më kompenzimet e tyre.

Pala ankuese në ankesë ka potencuar se përmbaruesi nuk i ka dorëzuar asnjëherë urdhërin përmbarimor i cili do t'i mundësonte parashtrimin e prapësimit, por i njëjti ka bërë bllokimin dhe tërheqjen e mjeteve nga llogaria e saj. Për këtë, pala ankuese e ka paraqitur rastin në gjykatë dhe do e paraqes edhe në Odën e Avokatëve të Kosovës për avokatin në fjalë. Ka deklaruar poashtu se me datën 01.06.2022 ka pranuar e-mail nga personi . thotë se është avokat nga

dhe ka kërkuar që të nënshkruaj një autorizim për përfaqësim në gjykatë, ku ky person si avokat ka deklaruar se ka përfaqësuar administratën e për kërkesën kolektive të bërë nga stafi i administratës së për kompenzimin e shujtës ushqimore dhe shpërblimet jubilarë. Pas kësaj, pala ankuese i është drejtuar zyrtarëve të ie kërkesën për sqarim se përse dhe nga kush është autorizuar ky person si avokat në emër të saj si paditëse.

Pala ankuese në vazhdim ka deklaruar se duket se nënshkrimin në listën e stafit të e ka keqpërdorur avokati së bashku me dikend nga vetë administrata e sepse ai nënshkrim ka qenë i drejtuar për këshillin drejtues të e jo autorizim për këtë avokat. Andaj, pasi atij i është kërkuar autorizimi i nënshkruar me datën 01.06.2022 nga ky avokat, nuk e ka nënshkruar asnjëherë atë autorizim dhe nuk e kishte të qartë se përse ky avokat ka vepruar pa autorizimin e tij.

### **I ka propozuar komisionit disiplinor që të ndërmerrë veprimet e nevojshme.**

Përmbaruesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim e ka kundërshtuar si të pa bazë ankesën e palës ankuese si dhe në fjalën e tij përfundimtare në seancë ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës lidhur me rastin konkret dhe se për këtë ka dhënë përgjegje në ankesë të cilën ia ka dorëzuar fillimisht Odës së Përmbarueseve dhe Komisionit Disiplinor.

Sa i përket mosdorëzimit të urdhërit tek debitorja kishte tentuar tri herë të bëjë dorëzimin e propozimit me të gjitha shkresat e tjera debitorëve. Lidhur me këto tentime janë edhe dëftesa me shkresat e lëndës. Tentimi i parë ka qenë 16.08.2022 në adresën personale të ankuseses, tentimi i dytë ka qenë me 15.09.2022 në adresën e vendqëndrimit të ankuseses, në tentimi i tretë ka qenë me 04.10.2022 në adresën e vendqëndrimit të ankuseses në pra ne vendin e punës. Janë 9 raste të tilla në he prej tyre 3 e kanë pranuar urdhrin dhe kanë ushtruar kundërshtim, ndërsa 6 prej tyre kanë refuzuar, njëra prej të cilëve është edhe ankuesja prezente.

Sa i përket faturës si dokument me të cilën është inicuar rasti, përmbaruesi ka theksuar se detajeve të faturës nuk i ka në kompetencë dhe nuk ka pse ta administrojë.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke filluar nga Fatura si dokument i besueshëm, pastaj komunikimet elektronike të palëve, përfshirë palës ankuese me kreditorin dhe zyrtarët e nënshkrimin në listën e stafit administrativ të autorizimin e pa nënshkruar nga pala ankuese, kërkesën për kompenzim nga avokati dërguar përmes komunikimit elektronik, procesverbalin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për lëndën, C.nr.1490/20, dt.05.05.2022, me të cilin është obliguar këtu keditori që t i dorëzoi gjykatës autorizimet e palëve paditëse, përfshirë këtu edhe palën ankuese, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1490/20, dt.24.06.2022, me të cilin është konsideruar se padia e paditësve ku bënë pjesë edhe pala ankuese është konsideruar e tërhequr në mungesë të dorëzimit



të autorizimit nga ana e përfaqësuesit të tyre, për palët paditëse si dhe provave tjera sikurse propozimi dhe aktet tjera për veprimet përbarimore të ndërmarrura nga ana e përbaruesit.

Pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, komisioni erdhi në përfundim se përbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni vlerëson se sa i përket pretendimeve të përbaruesit privat që janë në kundërshtim me ligjin dhe që e kanë tejkaluar autorizimin e tij me rastin e zbatimit të përbarimit, përbaruesi privat nuk kishte vepruar në bazë të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurës përbarimore të rastit, pasi fillimisht dokumenti i besueshëm, fatura e lëshuar nga ana e kreditorit av

ne datën 21.06.2022, nuk ka fare numër të faturës, por referuar lëndës C.nr.1490/20, ndërsa në brendësi shënon Përfaqësim në lëndën për kompensim të shujtës ushqimore me sasi prej 1 copë dhe me cmim prej 104.00 euro, ndërsa në total figuron shuma prej 174.48 euro dhe TVSh 31.42 euro, që së bashku është e shënuar si shuma prej 205.90 euro, e njehta nuk është e nënshkruar, por e dërguar me postë elektronike tek debitorja nga ana e avokatit si kreditor.

Fatura ka mangësi në vet përmbajtjen e saj sa i përket shumave dhe këtë do duhej vet përbaruesi ta eliminoj, sepse sipas dispozitave të nenit 29 par.3. ceket se Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim, po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.

Përpos kësaj kreditori e dorëzoi faturën me emërtimin përfaqësim në lëndën C.nr.1490/20, për të cilën bazuar në shkresat e pranuar nga përbaruesi, shihet shumë qartë se i njejtë as nuk ka pasur autorizim për atë përfaqësim, gjë që dëshmohet me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1490/20, dt.24.06.2022, me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësve, përfshirë këtu palën ankuese, pikërisht për shkak të mos dorëzimit të autorizimit nga ana e përfaqësuesit të tyre avokatit, këtu kreditor.

Në shkresat e lëndës është administruar edhe autorizimi që asnjëherë nuk është nënshkruar dhe është si formë e pastër pa nënshkrim nga pala ankuese.

Me këtë dëshmohet se përbaruesi nuk i ka kushtuar kujdes sikurse edhe e ka obligim ligjor që të administroi së pari përmbajtjen e dokumentit të besueshëm se a i plotëson kriteret për përbarim, pastaj provave përcjellëse, ku është vërejtur sipas vendimit të gjykatës se kreditori nuk ka ofruar autorizim për këtë përfaqësim për interesat e palës ankuese që i bie se shërbimet e kryera, përbaruesi i ka kryer pa qenë fare i autorizuar nga ana e debitorës.

Me këtë rast komisioni vlerëson se përbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, nën paragrafi 1 i LPP-së, për arsyt e dhëna si më lart.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, pasi përbaruesi nuk ka qenë asnjëherë i gjetur përgjegjës deri më tani, përkundër që më herët ka pasur raste në komision disiplinor, por që në ato raste nuk është shpallur asnjëherë përgjegjës.

Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve e përbarimore, të përbaruesit privat si dhe tek përbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen

dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbartimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, edhe është edhe qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimin se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, komisioni e bazoi në nenin 368, paragrafi 3 të LPP-së, në të cilën përcaktohet se gjobat në të holla paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr 21/2022 datë 22.12.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor  
Manushe Karaçi



*M. Karaçi*

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.